



Plana / Dorezim Prenje / Pradato Received / Delivery	02-06	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	SKPM/SHK	3215/2022		
Shtojca Prilog Appendix				
Sasia Kolicina Quantity				1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.455/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë me Çlirim Zeka -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.455/2022 të datës 16.05.2022, të parashtruar nga ankuesja me përfaqësues juridik avokat kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 02.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën,A.nr.455/2022 të datës 16.05.2022, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja përmes postës së Kosovës nëpërmjet përfaqësuesit juridik me datë 16.05.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit zyrtar me e-mail mbi përfundimin e marrëdhënies së punës të datës 01.03.2022 dhe kompensimin e pagave të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 19.05.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datën 25.05.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot: 2806/2022 të datës 16.05.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 21.04.2021 lidhur me përfaqësimin e ankueses; Letërnjoftim i ankueses; Kontrata e Marrëdhënies së Punës e me numër protokolli 00219/20 i datës 02.11.2020; Përshkrimi i vendit të punës për recepcioniste; E-mail nga embassy.albania@rks-gov.net për i datës 01.03.2022; Kërkesë për njoftim zyrtar me numër protokolli 1487 i datës 28.04.2022; Pliko me numër R2258077 i datës 13.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2940/2022 i datës 19.05.2022; E-mail nga A.K. për A.P.Sh i datës 25.05.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 1794 e datës 25.05.2022; Fletëkthesë e datës 20.05.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke shqyrtuar provat e lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën A.nr.455/2022 të datës 16.05.2022, të parashtruar nga ankuesja **SEPSE:**

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesja ka themeluar marrëdhënie pune tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Tiranë në vendin e punës si "Recepcioniste" sipas kontratës së punës për kohë të caktuar nga data 02.11.2020 deri me datë 02.11.2023, të datës 02.11.2020. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 01.03.2022 përmes e-mailit zyrtar e njofton për përfundimin e marrëdhënies së punës me arsyetimin se kontrata e punës është nënshkruar pa respektuar asnjë procedurë rekrutimi dhe pa pëlqim paraprak nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që e bënë të jetë kontratë invalide. Ankuesja nëpërmjet të autorizuarit të saj i është drejtuar me kërkesë për njoftim zyrtar me numër protokolli 1487 të datës 28.04.2022 Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me definimin e statusit juridik të saj. Mirëpo deri më sot Ministria asnjëherë nuk i është përgjigjur.

Ankuesja përmes përfaqësuesit juridik me autorizim e pakënaqur me njoftimin përmes e-mailit zyrtar për përfundimin e marrëdhënies së punës të datës 01.03.2022, me ankesë i është drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 01.03.2022 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës dhe kompensimin e pagave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranueshmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafit 3 ku përcaktohet se: "3. Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë" si dhe nenit 2 paragrafi 6: "Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike," ndërsa mbi bazë të dispozitave të lartshënuara dhe bazuar në provat që gjinden në shkresat e lëndës konstatoi se pozita "Recepcioniste" nuk është pozitë e shërbimit civil sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenit 2 paragrafi 3 të këtij ligji. Duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet se këshilli është kompetent: "1.1. shqyrton dhe



merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në Shërbim Civil", mbi këtë bazë dhe arsyeve të specifikuara më lartë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.455/2022 të datës 16.05.2022 të parashtruar nga ankuesja

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.455/2022, datë 02/06/2022.

Çlirim Zeka

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses avokatit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK- së;

